

E ENJTE DATA 2 MARS 2023

FJALA E DEPUTETIT ENKELEJD ALIBEAU

Të nderuar qytetarë shqiptarë,

U bënë dy muaj që Kryeministri i vendit i fshihet parlamentit, ju fshihet juve për një nga çështjet më të rëndësishme, e cila ka prekur përditë jo vetëm publikun shqiptar, por edhe atë amerikan, madje deri në analet e drejtësisë amerikane. Sigurisht, taktika ka qenë që të fshihet dhe të krijohet zhurmë, në mënyrë që publiku të mos dëgjojë, të mos kuptojë dhe të mos vlerësojë. Në fakt, për të tretën herë, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike dhe unë personalisht kërkojmë një interpelancë, që Kryeministri i vendit të vijë para Kuvendit dhe t'u flasë shqiptarëve për atë çfarë di, çfarë ka bërë, pra reagimi që ai duhet të mbajë në postin e Kryeministrit dhe jo të shtetasit Edi Rama. Megjithatë, pa humbur kohë, po kaloj te parashtrimi i interpelancës që duhet të kishte ndodhur 2 muaj më parë, bazuar në një dokument të drejtësisë amerikane, dhe është pikërisht padia e "Jurisë së madhe" të Distriktit të Kolumbias, e bërë publike më 24 janar 2023, e cila daton që më 15 shtator 2022, për çështjen penale që Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë ngritur kundër Charles McGonigal-it, ndaj të cilit rëndojnë akuzat penale për fshehje të të ardhurave, deklaramë të rreme, falsifikim dokumentesh apo të dhënash. Nga përmbajtja e këtyre dokumenteve, pa dalë fare nga dokumentet mediatike, nga komentet e me radhë, duke qëndruar strikt, rezulton se përshkruhen disa veprimtari të kryera nga shtetas shqiptarë, duke përfshirë zotin Edi Rama, me detyrë Kryeministër i Republikës së Shqipërisë, zotin Agron Neza, mik i Kryeministrit dhe zotin Dorian Duçka, këshilltar jozyrtar i Kryeministrit.

Konkretisht, sipas të dhënave të aktpadisë, zoti Neza i ka paguar ish-drejtorit të kundërzbulimit të FBI-së, zotit McGonigal, shumë prej 225 mijë dollarësh, me qëllim që ky të ushtronte autoritetin e tij për të filluar një çështje penale ndaj lobistit amerikan të një partie tjetër, kundërshtare me Partinë Socialiste. Informacionet dhe të dhënat janë ofruar nga zyra e Kryeministrit shqiptar. Ndërkohë, nga të dhënat e aktpadisë rezulton se zoti Neza dhe zoti Duçka kishin interesa të drejtpërdrejta në dhënie e licencave për sektorin e naftës në Shqipëri. Në mediat shqiptare janë publikuar të dhëna dhe dokumente zyrtare që provojnë se zoti McGonigal dhe zoti Neza janë bërë ortakë të një studioje ligjore shqiptare, e cila ishte në pronësi të zotit Shefqet Dizdari. Ky i fundit rezulton që në vitin 2018, nëpërmjet kompanisë së tij "Transoil Group" sh.a., më pas "Terraoil Swiss" sh.a., të ketë përfituar koncesionin e tri fushave naftëmbajtëse në Jug të Shqipërisë. Referuar vendimit nr. 781, datë 27.06.2019, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, rezulton se përzgjedhja e kësaj kompanie është kryer nën favorizim dhe shkelje të barazisë në tendera, duke i sjellë buxhetit të shtetit një dëm të përlogaritur në vlerën 300 milionë dollarë. Faktet dhe provat e mësipërme dëshmojnë qartë se personat e përfshirë kishin tre qëllime. Kryeministri Edi Rama kishte si qëllim fillimin e një çështjeje penale për lobistin amerikan të angazhuar nga Partia Demokratike, e cila më pas do të shërbente për fillimin e një hetimi penal nga autoritetet shqiptare. Për Agron Nezen dhe Dorian Duçkën qëllimi ishte i thjeshtë: përfitimi i licencave koncesionare në sektorin e naftës dhe për agentin McGonigal përfitimi i shumës 225 mijë dollarë dhe të tjera fitime nga bizneset në Shqipëri. Të tre këto qëllime për secilin janë realizuar nëpërmjet mjeteve të paligjshme. Në këtë interpelancë janë një seri pyetjesh, të cilave Kryeministri i vendit duhet t'u japë përgjigje. Po i listoj të gjitha. Nga dokumentet rezulton se janë realizuar 4 takime midis Kryeministrit dhe personave të mësipërm. Pyetjet e mia janë:

1. Cilët janë personat që kanë qenë në katër takimet e cituara në aktpadi? 2. Kush ka qenë i pranishëm në takimin e 17 shtatorit 2017, përveç Kryeministrit, Dorian Duçkës dhe McGonigal-it? 3. Takimi zhvillohej si takim privat apo si takim zyrtar? A u prezantua si zyrtar i lartë i FBI-së, zoti McGonigal? 4. Pse është diskutuar çështja e dhënies së licencave të fushave të shfrytëzimit të naftës në Shqipëri, në këtë takim? 5. A keni qenë në dijeni, zoti Kryeministër, se personi Agron Neza dhe Dorian Duçka kishin interesa financiare në fushën e shfrytëzimit të naftës? 6. A keni marrë masa ju që licenca e shfrytëzimit të naftës të mos i jepej personit Agron Neza dhe Dorian Duçkës në shkelje të ligjit? 7. Çfarë masash keni marrë ju, zoti Kryeministër, pasi gjykata vendosi që leja e shfrytëzimit të tri parcelave naftëmbajtëse, që iu dha një shoqërie, asaj të Shefqet Dizdarit, ishte me shkelje ligjore? 8. A keni bërë ju deklaram në ILDKPKI për situatë konflikti interesi tuajën rreth kësaj çështjeje? A keni kontrolluar ju që ndonjë nga ministrat tuaj të kohës të ketë bërë një deklaram të tillë? 9. Sa herë keni kontaktuar në telefon, me mesazhe, me email, me mjete të tjera komunikimi apo takime fizike, me mikun tuaj McGonigal prej shtatorit 2017 e në vijim? 10. Kush ka qenë i pranishëm në takimin e dytë që keni pasur më 20 nëntor 2017, përveç jush? Çfarë keni diskutuar në atë takim? 11. Takimi ka qenë i natyrës private apo zyrtare? A i keni dhënë ju informacion zotit McGonigal rreth lobimit në Shtetet e Bashkuara të një partie tjetër, të ndryshme nga partia juaj? 12. Cili zyrtar nga zyra juaj, pra nga zyra e Kryeministrit, i ka dhënë informacion Dorian Duçkës në lidhje me lobimin? 13. Si e shpjegoni ju që 4 ditë më pas, pra në datën 24 nëntor, McGonigal ka marrë nga këshilltari juaj informal Dorian Duçka informacion për të stisur procedimin penal ndaj lobistit të partisë tjetër kundërshtare me tuajën? 14. Në dhjetor të vitit 2017 keni pasur një tjetër takim, keni darkuar me McGonigal dhe personin A, Agron Nezen, në Nju Jork. A është diskutuar mes jush dhënia e informacioneve tek Agron Neza (përveç asaj çfarë i ishte dhënë më parë Dorian Duçkës) lidhur me lobimin e Partisë Demokratike? 15. Si e shpjegoni ju që këtë radhë Agron Neza kishte gjetur një informacion për lobistin e partisë tjetër kundërshtare me ju dhe disa ditë më vonë, në datën 4 janar, ia kishte kaluar zotit McGonigal? 16. A keni kërkuar ju në këtë takim që zoti McGonigal të ndërhynte për të stisur një çështje penale në Shtetet e Bashkuara të Amerikës? 17. Si e shpjegoni që Agron Neza është furnizuar me informacion përsëri, këtë radhë në datën 22 janar, lidhur me lobistin e partisë tjetër, në funksion të stisjes së çështjes penale kundër Partisë Demokratike? 18. Cili nga zyrtarët e zyrës së Kryeministrit të Shqipërisë ia ka dhënë këtë informacion Agron Nezës? 19. McGonigal-i ka qenë në Shqipëri në shkurt të vitit 2018. A e keni takuar? Nëse jo, a ju ka informuar këshilltari juaj Dorian Duçka për takimin që ai ka pasur me të në Tiranë? 20. A ju ka informuar këshilltari juaj informal se ai po mbështeste hetimin dhe pyetjen e dëshmitarëve në funksion të hetimit të stisur ndaj lobistit të Partisë Demokratike? 21. Në mars të vitit 2018, i katërti takim, keni darkuar së bashku me McGonigal-in dhe Agron Nezen në Nju Jork. A është diskutuar fakti se Agron Neza kishte marrë informacion nga zyra juaj dhe ia kishte përcjellë McGonigal-it? Po për faktin se Agron Neza po mbështeste hetimin e stisur, duke u paraqitur ai vetë si dëshmitar në këtë hetim? 22. Cili ishte agjenti tjetër, i cili ishte duke darkuar me ju? 23. Si shpjegohet që menjëherë pas takimeve me Kryeministrin, agjentit të FBI-së i janë paguar plot 225 mijë dollarë nga Agron Neza? 24. Si shpjegohet që menjëherë pas takimeve me Kryeministrin, agjenti i FBI-së inicion hetimin penal për lobistin amerikan të Partisë Demokratike? 25. A mundet Kryeministri të provojë se Agron Neza nuk ka vepruar i porositur prej tij, kur ka deklaruar se kishte informacion për lobistin e Partisë Demokratike, të marrë nga zyra e Kryeministrit shqiptar? 26. Cili ishte burimi i drejtuesve të Partisë Socialiste që flisnin për një çështje penale ndaj lobistit amerikan të Partisë Demokratike, ndërkohë që çështja ishte nën hetim dhe mbulohej nga sekreti hetimor? 27. Çfarë natyre kanë pasur marrëdhëniet e Kryeministrit me zotin Dorian Duçka? 28. Cila është arsyeja që ky shtetas është pajisur me pasaportë diplomatike, madje edhe me një email qeveritar, në një kohë kur ishte i angazhuar në një aktivitet privat? Së fundi, pse qeveria shqiptare i ka dhënë koncesione dhe statusin e investitorit strategjik oligarkut rus Oleg Deripaska, pas vendosjes së tij nën sanksione amerikane? Këto janë pyetjet, të cilat doja t'i parashtroja në këtë interpelancë.

Së fundi, ajo që dua të them për këdo që duhet të përgjigjet, Kryeministri këtë radhë, vetëm e vërteta është shpëtimi në këtë rast. Këto pyetje janë sot pezull mbi këtë parlament dhe do të jenë nesër, me sa duket, edhe në prokurori. Faleminderit!